



# KËRKESAT PËR AZIL RRITEN PAS LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

FAQE 4-5



Nga janari deri në korrik të këtij viti mesatarisht mbi 550 qytetarë të Kosovës kanë kërkuar azil në vendet e Evropës çdo muaj. Kjo

shifër është dukshëm më e lartë se mesatarja në gjashtë vjetët e kaluar. Më shumë kërkesa për azil ka pasur vetëm në vitet

2015/2016, kur dhjetëra mijëra kosovarë kanë emigruar drejt BE-së përmes rrugëve ilegale të Hungarisë

### KURTI KRITIKON BLOKIMIN E LIGJIT PËR FONDIN SOVRAN NGA KUSHTETUESJA: UROJ TË MOS DALIN PARALAJMËRIMET E OPOZITËS

F. 4



### TRUMPI EMËRON MUSKUN NË KRYE TË NJË DEPARTAMENTI TË RI

F. 4



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## OPINION

### RETORIKA ANTI-TRUMP DHE MANIPULIMI POLITIK NË KOSOVË

F. 6

Bekim  
ÇOLLAKU



## AKTUALE



### KOSOVA KUNDËR ZGJIDHJEVE ME SERBINË QË PREKIN TERRITORET

F. 4

### VELI BYTYQI, KANDIDAT I NISMËS PËR DEPUTET

F. 7

## EKONOMI



### BIE IMPORTI I GRURIT

F. 8

### HAMZA TAKON SHOQATËN E BIZNESEVE NË PRIZREN: DO TA HEQIM PAGESËN NË KUFË PËR TVSH-në

F. 8

## SPORT



### JASHARI DHE EMËRLLAHU: MUND TA MPOSHTIM RUMANINË

F. 10



# Trumpi emëron Muskun në krye të një departamenti të ri

WASHINGTON, 13 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur amerikan, Donald Trump, do ta emërojë Elon Muskun në një rol që synon të krijojë një qeveri më efikase, duke i dhënë edhe më shumë ndikim njeriut më të pasur në botë, i cili dhuroi miliona dollarë për ta ndihmuar Trumpin që të fitonte zgjedhjet presidenciale. Musk dhe ish-kandidati republikan për president, Vivek Ramaswamy, do të drejtojnë së bashku një Departament të sapokrijuar për Efikasitetin e Qeverisë, entitet që, sipas Trumpit, do të operojë jashtë ekzekutivit amerikan. Përmes një deklarate, Trumpi tha se Muskun dhe Ramaswamy "do t'i mundësojnë administratës sime që ta zhdukë burokracinë qeveritare, ta zvogëlojë numrin e rregulloreve të tepërta, t'i shkurtojë shpenzimet e kosta dhe t'i ristrukturojë agjencitë federale". Trumpi tha se ky departament i ri do t'i realizojë ëndrrat e kamotshme të republikanëve dhe do të ofrojë "këshilla dhe

udhëzime nga jashtë qeverisë", duke sinjalizuar se rolet e Muskut dhe Ramaswamy mund të jenë joformale dhe nuk do të ketë nevojë për miratimin e Senatit për emërimin e tyre. Një gjë e tillë do t'i mundësonte Muskut që të mbeste në krye të kompanisë së tij për makina elektrike, Tesla, të platformës sociale X, dhe të kompanisë së raketave, SpaceX. Departamenti i ri do të punojë me Shtëpinë e Bardhë dhe Zyrën për Menaxhim dhe Buxhet për t'i "udhëhequr reformat në shkallë të gjerë dhe për të krijuar një qasje të formës sipërmarrëse" ndaj qeverisë që nuk është parë më parë, tha Trumpi. Puna e këtij departamenti, sipas Trumpit, do të përfundonte më 4 korrik 2026, në 250-vjetorin e nënshkrimit të deklaratës së pavarësisë së ShBA-së. Musk, i listuar si personi më i pasur në botë nga revista "Forbes", veçse pritej të përfitonte nga fitorja e Trumpit, pasi sipërmarrësi miliarder pritet të ushtrojë ndikim të jashtëzakonshëm për të ndihmuar kompanitë e tij dhe për



të siguruar trajtim më të favorshëm nga qeveria. Muskun ka dhënë miliona dollarë për të mbështetur fushatën e Trumpit për zgjedhjet presidenciale dhe të dy kanë pasur edhe dalje publike. Trumpi i ka lidhur përpjekjet për efikasitet me Projektin Manhattan, ndërmarrja e SHBA-së për krijimin e bombës bërthamore që ndihmoi në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, teksa Muskun premtoi se do të ketë transparencë. "Të gjitha veprimet

e Departamentit për Efikasitet të qeverisë do të publikohen online me transparencë maksimale", tha Muskun në X, duke i kërkuar publikut që të japë këshilla. "Ne, po ashtu, do të merremi me shpenzimet e mëdha të dollarëve të taksave tuaja. Do të jetë jashtëzakonisht tragjike dhe jashtëzakonisht argëtuese", tha Musk. Në tetor, gjatë një tubimi të Trumpit, Muskun kishte deklaruar se buxheti federal mund të ulet "për të paktën" 2 trilionë dollarë.

Sipas Zyrës së Buxhetit në Kongres, shpenzimet diskrecionale, përfshirë shpenzimet e mbrojtjes, vlerësohet se janë 1.9 trilionë dollarë nga 6.75 trilionë dollarë sa janë shpenzimet e përgjithshme federale për vitin fiskal 2024. "Paratë tuaja po shpërdorohen dhe Departamenti për Efikasitet të Qeverisë do ta rregullojë këtë problem", tha Muskun gjatë tubimit. Ndërkaq, Ramaswamy është themelues i një kompanie farmaceutike. Ai kishte garuar kundër Trumpit për nominimin e republikanëve por, kur u tërhoq nga gara, ai mbështeti ish-presidentin Trump. Në një libër të publikuar më 2021, Ramaswamy ka kritikuar vendimet e disa kompanive të mëdha që bazojnë strategjinë e tyre të biznesit rreth drejtësisë sociale dhe shqetësimeve për ndryshimet klimatike. Ramaswamy tha se ky emërim nënkupton se ai do të tërhiqet nga synimi për t'u emëruar anëtar i Senatit në Ohajo.

# Blinken: Dislokimi i trupave koreanoveriore kërkon përgjigje të vendosur

BRUKSEL, 13 NËNTOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, paralajmëroi se dislokimi i trupave të Koresë së Veriut përkrah forcave ruse, që luftojnë në kufirin ukrainas, kërkon "përgjigje të vendosur". Blinken tha se ka diskutuar me shefin e NATO-s, Mark Rutte, për faktin që forcat koreanoveriore janë "përfshirë në betejë, dhe tani, në luftime dhe kjo kërkon dhe do të ketë një përgjigje të vendosur". Blinken u takua me Rutten në Bruksel, teksa administrata në largim e presidentit amerikan, Joe Biden, po tenton të çimentojë mbështetjen për Ukrainën, para se republikani Donald Trump ta marrë detyrën



e presidentit. Pas fitores në zgjedhjet presidenciale, Trumpi është zotuar se do të ndalë luftërat në Ukrainë dhe Lindje të Mesme. Gjatë adresimit për media, Rutte

tha se presidenti rus, Vladimir Putin, nuk duhet të lejohet që të jetë i suksesshëm në Ukrainë. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Së fundi, intelijenca e ShBA-së,

ajo e Koresë së Jugut, e NATO-s dhe Ukrainës kanë konfirmuar se Koreja e Veriut ka dislokuar në Kursk të Rusisë trupa për ta ndihmuar Moskën në luftën kundër shtetit fqinj. ShBA-ja ka thënë se në Kursk - që ndodhet në kufi me Ukrainën - gjenden afër 10 000 trupa të Koresë së Veriut, por Ukraina ka thënë se numri ka shkuar deri në 12 000. Po ashtu, Rusia ka zhvendosur disa burime në rajonin kufitar të Kurskut për t'iu përgjigjur ofensivës që Ukraina nisi në gusht, pasi forcat ruse kanë hasur në vështirësi që t'i zmbarsin trupat ukrainase. Gjatë qëndrimit në Bruksel, kryediplomati amerikan foli edhe për luftën mes Izraelit dhe

Hamazit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - në Gazë, që ka nisur në tetor të vitit të kaluar. Blinken i bëri thirrje Izraelit të zbatojë "pauza të vërteta dhe të zgjata" në luftime, në mënyrë që të lejohet dërgimi i ndihmave humanitare në Gazë. "Duhet të shohim pauza të vërteta dhe të zgjata në pjesë të mëdha të Gazës, pauza në luftime, të çdo luftimi, në mënyrë që ndihma të arrijë në mënyrë efektive të njerëzve që kanë nevojë", tha Blinken, duke shtuar se Izraeli po ndërmerr hapa për të adresuar situatën e rëndë humanitare në territorin palestinez.

## Kina mban stërvitje ushtarake afër Filipineve

SKARBORO, 13 NËNTOR - Kina ka mbajtur stërvitje detare dhe ajrore më 13 nëntor afër Cekëtinës të kontestuar Skarboro, një zonë e pabanuar me shkëmbinj nënujorë, që është marrë nga Filipinet në Detin Jugor të Kinës. Ditë më parë, Kina publikoi vija të reja për këtë pjesë, përfshirë edhe koordinatat gjeografike. Tensionet mes Kinës dhe Filipineve janë rritur lidhur

me pretendimet për Cekëtinën e Skarboros dhe pjesëve të tjera në Detin Jugor të Kinës. Në këto zona ka pasur edhe përleshje, pasi Rojet Bregdetare të Kinës kanë hedhur topa me ujë në drejtim të anijeve të Filipineve. "Ky është një aktivitet patrullues që u krye nga trupat detare, në bazë të ligjit", tha komanda qendrore e ushtrisë kineze përmes një deklarate.

Kina mori këtë ceketinë, që gjendet në perëndim të ishullit Luzon të Filipineve, më 2012 dhe që atëherë nuk lejoi që peshkatarët e Filipineve të peshkojnë në atë zonë. Më 2016, Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit gjeti se shumica e pretendimeve të Kinës për Detin Jugor të Kinës ishin të paqëndrueshme, por Pekini ka refuzuar që ta respektojë këtë vendim.





## Kërkesat për azil rriten pas liberalizimit të vizave

Nga janari deri në korrik të këtij viti, mesatarisht mbi 550 qytetarë të Kosovës kanë kërkuar azil në vendet e Evropës çdo muaj. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se mesatarja në gjashtë vjetët e kaluar. Më shumë kërkesa për azil ka pasur vetëm në vitet 2015/2016 kur dhjetëra mijëra kosovarë kanë emigruar drejt BE-së përmes rrugëve ilegale të Hungarisë

PRISHTINË, 13 NËNTOR - "Kush del i fundit, le t'i ndalë dritat"... Komente si ky kishin shoqëruar lajmin se kosovarët do të mund të udhëtonin pa viza nëpër vendet e zonës Schengen nga 1 janari i këtij viti. Që nga muaji prill i vitit të kaluar, kur u dha ky lajm, liberalizimi i vizave ishte parë me shqetësim nga organizatat joqeveritare në Kosovë, të cilat brengoseshin se "ikja e trurit" mund të përkeqësohej. Instituti për Studime të Avancuara, GAP, raportonte se gati 30 për qind e qytetarëve të Kosovës planifikonin të emigronin nga vendi pas liberalizimit të vizave. Edhe pse problemet në tregun e punës, shkak i emigrimit, nuk janë rritur aq sa është paralajmëruar nga shumë OJQ, të dhënat e Zyrës së Statistikave të BE-së, Eurostat, tregojnë se ka pasur një rritje të numrit të aplikimeve për azil në BE. Nga janari deri në korrik të këtij viti, mesatarisht mbi 550 kosovarë kanë

kërkuar azil në vendet e Evropës çdo muaj. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se mesatarja në gjashtë vjetët e kaluar. Më shumë kërkesa për azil ka pasur vetëm në vitet 2015/2016 kur dhjetëra mijëra kosovarë kanë emigruar drejt BE-së përmes rrugëve ilegale të Hungarisë. Vetëm në shtatë muajt e parë të këtij viti janë bërë gjithsej 3 950 kërkesa për azil - dukshëm më shumë sesa gjatë tërë vitit në katër vjetët paraprakë. Numri më i lartë i kërkesave për azil këtë vit u regjistrua në maj, kur u bënë gjithsej 765 kërkesa. Pjesa më e madhe e tyre ishin bërë në Francë. Franca ka qenë destinacion kryesor i kosovarëve që kërkojnë azil në BE qysh nga viti 2018, kur për herë të parë zuri vendin e Gjermanisë si destinacion kryesor. Gjermaninë e kanë synuar shumë kosovarë në vitet e fundit, për shkak të procedurave të lehtësuara për



punësim. Por, pasi procedurat lejojnë marrjen e vizës së punës përmes një shorti, në kërkesat për azil nuk përfshihen këta persona. Meqenëse Gjermania nuk e lejon nënshtrësinë e dyfishtë - përveç në disa raste - ajo mbetet vendi kryesor për të cilin kosovarët heqin dorë nga nënshtrësinë e Kosovës. Por, të dhënat e publikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës tregojnë se numri i kërkesave për lirim nga shtetësia, ka qenë në rënie përgjatë vitit 2024. Ndërsa kërkesat për lirim nga shtetësia e Kosovës ishin në rënie, numri i udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës u rrit dukshëm. Me oferta të shumta nga agjenci turistike dhe pa nevojën për të

aplikuar për vizë, shumë kosovarë e shfrytëzuan mundësinë e udhëtimit në zonën Schengen, e cila përbëhet prej 29 vendesh evropiane. Numri i udhëtarëve përmes transportit ajror në Kosovë është rritur në krahasim me vitin e kaluar, por trendi i rritjes ka nisur edhe në vitet paraprake. Organizata të ndryshme joqeveritare dhe institucione shtetërore, në disa raste, kanë theksuar nevojën që kosovarët t'i respektojnë kushtet e udhëtimit pa viza.

### E cilat janë kushtet?

Liberalizimi mundëson udhëtime pa viza vetëm deri në 90 ditë -

brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga 29 shtetet anëtare të zonës Schengen.

Udhëtimet pa viza duhet të shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme, dhe assesi për punë apo përfitime të tjera.

Në të kundërtën, Bashkimi Evropian ka në dorë të ashtuquajturin Mekanizëm të pezullimit të vizave. Me këtë mekanizëm, një vendi joanëtar të BE-së, si Kosova, mund t'i pezullohet përkohësisht përjashtimi nga vizat, nëse bën keqpërdorime.

Janë katër skenarë ku Mekanizmi i pezullimit të vizave do të aktivizohet: Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50% - të migrimit të parregullt. Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50% - të kërkesave për azil me shkallë të ulët pranimit, rreth 3-4%. Në rast të rënies së bashkëpunimit për riatdhesimin e shtetasve që përjashtohen nga BE-ja, si rezultat i qëndrimit të parregullt. Në rast të rrezikut të shtuar për sigurinë e shteteve anëtare të BE-së, veçanërisht për vepra penale të rënda.

Deri më tani BE-ja nuk ka shprehur shqetësim për rritje të migrimit apo kërkesave për azil nga Kosova, e as organizatat që përfaqësojnë bizneset nga Kosova nuk kanë shprehur shqetësim se punëtorët po ikin në mënyrë masive.

## Ambasada e Britanisë dhuron katër dronë për Policinë e Kosovës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti dhe ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves, në kuadër të partneritetit dhe bashkëpunimit, kanë nënshkruar marrëveshje mbi pranim-dorëzimin e një donacioni mjaft të rëndësishëm për Policinë e Kosovës.

Kjo marrëveshje ka të bëjë me dhurimin e katër dronëve, të cilët do t'i ndihmojnë njësitet policore në raste të ndryshme, si në identifikimin, gjurmimin, monitorimin dhe përcaktimin e vendndodhjes së automjeteve dhe personave të dyshimtë. Duke përdorur imazhërinë/rezolucionin e lartë dhe aftësitë termale të këtyre pajisjeve, mund t'i ndihmojnë njësitet policore për marrje të vendimeve të bazuara në informacion, fotografi, xhirime dhe imazhe/prova.

Pajisjet e specializuara do të luajnë një rol jetësor në Polici të Kosovës, do ta rrisin dhe do ta profesionalizojnë edhe më tej punën e Policisë së Kosovës, në veçanti të njësiteve kufitare të cilat kujdesen për parandalim të krimin



transkufitar, kontrabandës dhe migrimit të paligjshëm. Policia e Kosovës falënderon

Ambasadën e Britanisë në Kosovë për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj Policisë së

Kosovës, e cila këtë donacion do ta vërë në funksion të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike,

patrullimit kufitar, si dhe shërbimit sa më efikas e cilësor ndaj qytetarëve dhe vendit.





# Kosova kundër zgjidhjeve me Serbinë që prekin territoret

Qeveria e Kosovës thotë se përpjekja eventuale për ndarje të Kosovës, nën petkun e shkëmbimit territorial, “nuk është projekt paqësor dhe ndez konflikt të gjerë e të gjatë në Ballkan”. Ideja u riaktualizua javën e kaluar, kur kandidatja për komisionare të Zgjerimit të Bashkimit Evropian, Marta Kos, dha deklarata kundër saj. “Komisioni Evropian dhe unë, nëse konfirmohem, nuk do t’i ndjekim këto tendenca”, tha Kos në një seancë dëgjimore në Parlamentin Evropian

**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Për Qeverinë e Kosovës, shkëmbimi i territoreve me Serbinë, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nuk duhet të vihet në diskutim. Ajo thotë se ka qenë dhe është kundër idesë së tillë. “Qeveria e Kosovës refuzon projekte e zgjidhje me karakter territorial”, thotë zëdhënësi Përparim Kryeziu për Radion Evropa e Lirë. Ideja u riaktualizua javën e kaluar, kur kandidatja për komisionare të Zgjerimit të Bashkimit Evropian, Marta Kos, dha deklaratë kundër saj. “Komisioni Evropian dhe unë, nëse konfirmohem, nuk do t’i ndjekim këto tendenca”, tha Kos në një seancë dëgjimore në Parlamentin Evropian. Po atë javë zgjedhjet presidenciale në ShBA i fitoi ish-presidenti republikan, Donald Trump, i cili do ta marrë mandatin nga janari i vitit të ardhshëm. Në administratën e parë të

Trumpit, nga viti 2017 deri më 2021, ka pasur disa zyrtarë, si këshilltari i atëhershëm për siguri kombëtare, John Bolton, që nuk e kanë përjashtuar opsionin e “korrigjimeve territoriale” mes Kosovës dhe Serbisë. “Ne nuk do të jemi pengesë dhe nuk mendoj se dikush në Evropë do të qëndrojë në mes, nëse dy palët në konflikt arrijnë një marrëveshje të kënaqshme”, ka thënë Bolton në gusht të vitit 2018. Po atë muaj, edhe vetë presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shpallur në një forum në Austri idenë e tij për korrigjimin e kufijve me Serbinë. Ngjashëm edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka folur për ndarje ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Ndonëse asnjëri nuk ka ofruar propozime konkrete, është përfolur që veriu i Kosovës, i banuar me shumicë serbe, të shkëmbehet me jugun e

Serbisë, ku jeton popullatë shqiptare. Këto ide si në Kosovë ashtu edhe në Serbi kanë hasur në reagime për dhe kundër. Edhe aleatët kryesorë të Kosovës në Evropë, Britania dhe Gjermania, kanë thënë se thirrjet për ndryshim të kufijve të Ballkanit mund të sjellin destabilizim. Këtë qëndrim ka sot Qeveria e Kosovës, e cila thotë se përpjekja eventuale për ndarje të Kosovës, nën petkun e shkëmbimit territorial, “nuk është projekt paqësor dhe ndez konflikt të gjerë e të gjatë në Ballkan”.

## “Vetëm spekulime”

Për James Ker-Lindsay, profesor në Shkollën Ekonomike të Londrës, përmendja e idesë për shkëmbimin e territoreve tani bazohet vetëm në spekulime dhe asgjë konkrete. “Kjo ishte në agjendë më herët [në administratën e parë të Trumpit]. Mendoj se nuk ka asnjë justifikim se po flitet diçka [rreth kësaj teme]”, thotë Ker-Lindsay për Radion Evropa e Lirë. “Mendoj se shumë do të varet se kush do të jetë në krye të ekipit të tij për politikë të jashtme dhe nëse ata do të jenë të interesuar për Ballkanin”, shton ai. Trump, sipas tij, është i interesuar “vetëm aty ku mendon se mund të arrijë

marrëveshje që mund ta bëjnë të duket mirë”. “Dhe, nëse mendon se Ballkani nuk i ofron diçka të tillë dhe nuk e ka askënd përreth që i thotë se mund të bëjmë diçka në Ballkan, ai nuk do të brengoset”, thotë Ker-Lindsay. Aleksandar Popov, drejtues i Qendrës joqeveritare për Rajonalizëm në Novi Sad të Serbisë, thotë se nuk e di se kush është duke e iniciuar tashmë idenë e shkëmbimit të territoreve. Ai thotë se Vuçiqit do t’i konvenonte rikthimi i kësaj ideje në diskutim por, sipas tij, ajo nuk përkon me realitetin në terren. “Shumëçka ka ndryshuar. Pushteti i Kosovës ka arritur që institucionet serbe që funksiononin atje - përveç shëndetësisë dhe arsimit - t’i shuajë tërësisht. Kështu që mendoj se kjo ide është e vdekur. Kushdo qoftë nga SHBA-ja, nga administrata e saj, që e analizon këtë situatë, do ta kuptojë që, para së gjithash, Prishtina nuk do ta pranojë”, thotë Popov. Radio Evropa e Lirë kontaktoi Presidencën dhe Qeverinë e Serbisë për të kërkuar komentet rreth këtyre ideve, por prej asnjërit institucion nuk mori përgjigje. David Kanin, profesor i Studimeve Evropiane në Universitetin “Johns Hopkins” në Uashington, thotë se gjasat e rikthimit të idesë së shkëmbimit të territoreve në diçka konkrete, tash për tash, janë të vogla. “Shkëmbimi i

territoreve nuk do të rikthehet në të njëjtën mënyrë si përpara, sepse aktorët kanë ndryshuar - së paku njëri prej tyre. Marrëveshja është folur në kuadër të një pajtimi mes Thaçit dhe Vuçiqit, të cilët i kanë besuar njëri-tjetrit”, thotë Kanin, duke aluduar në deklaratat e Thaçit dhe Vuçiqit më 2018. Sipas Kaninit, mes kryeministrit aktual të Kosovës, Albin Kurtit, dhe Vuçiqit, nuk ka bashkëpunim të tillë. Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e BE-së, janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011. Ato kanë arritur dhjetëra marrëveshje, por shumë prej tyre mbeten pa u zbatuar dhe për këtë palët fajësojnë njëra-tjetrën për mungesë angazhimi. Kurti dhe Vuçiqi nuk janë takuar qysh në shtator të vitit 2023. BE-ja, në anën tjetër, ua ka bërë me dije se rruga e tyre drejt integritit evropian, varet ekskluzivisht nga normalizimi i marrëdhënieve. Kandidatja për shefe të politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, tha të martën se “Ballkani Perëndimor është rajon shumë i rëndësishëm” dhe se do të punojë që zgjerimi i BE-së të bëhet realitet.



# Kurti kritikon bllokimin e Ligjit për Fondin Sovran nga Kushtetuesja: Uroj të mos dalin paralajmërimet e opozitës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilën janë marrë vendime të ndryshme.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se në shkurt të vitit 2022 kanë miratuar në qeveri koncept-dokumentin për Fondin Sovran, që qëmton modelet më të suksesshme në botë dhe propozon rrugën e veçantë që duhet ta ndjekë Fondi Sovran i Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se ka kaluar një vit e gjysmë që e kanë miratuar në qeveri projektligjin që i hap rrugë themelimit të Fondit. “Në dhjetor 2023 në Kuvendin e Republikës e kemi miratuar Ligjin për Fondin Sovran të Republikës së Kosovës. Kurse muajin tjetër bëhet një vit prej kur ligji është në sirtarët e Gjykatës Kushtetuese. Çdo ditë që po kalon është kohë e humbur dhe jashtëzakonisht e vlefshme, meqenëse po pengohet shteti ynë në një kohë të ndryshimeve dhe mundësive të mëdha në ekonominë botërore, teksa ne

shënojmë rritjen më të madhe ekonomike të shoqëruar me progresin më të lartë demokratik”, është shprehur Kurti.

Sipas tij, Fondi Sovran është jetik për rritjen ekonomike, shtimin e investimeve e pasurimin e strukturës së investimeve. “Urojmë që paralajmërimet opozitare, që Gjykata Kushtetuese do ta hedhë poshtë ligjin tonë për Fondin Sovran të Kosovës, sipas informacioneve të tyre të brendshme, të mos dalin të sakta. Pra, urojmë që të ndërpritet avazi i bllokimit të reformave pozitive e progresiste, siç ndodhi me Ligjin për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me Ligjin për Çmimin Tavan për produktet bazë, ndër të tjera”, ka thënë ai.

Kurti ka thënë se për ta dëshmuar punën e madhe dhe tejet të rëndësishme që mund të bëhet brenda një viti, me institucionet që kanë themeluar, mund ta marrin si shembull Institutin për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë. “Ky institut u themelua nga

nevoja për ta ruajtur dhe për ta dokumentuar të vërtetën e vuajtjeve dhe sakrificës së popullit të Kosovës. Këtë javë Instituti paraqiti raportin njëvjetor të punës. Nëse do t'i rendisnim materialet e grumbulluara si foldera që qëndrojnë në këmbë, do të bëhej një seri e tyre e gjatë 189 metra apo, thënë ndryshe, 15.8 terrabajt, e gjithë kjo falë përkushtimit të të gjithë atyre që kanë kontribuar: qytetarëve, organizatave, institucioneve, komunave, ministrive, gazetarëve, aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe koleksionistëve të ndryshëm. Falënderoj secilën e secilin prej jush për dëshmitë që keni ndarë dhe për kujtimet që keni ruajtur. Ju ftoj të gjithëve që të vazhdoni ta mbështesni Institutin drejt realizimit të këtij misioni të drejtë e fisnik të tij. E dimë se ky proces nuk është i lehtë, por është thelbësor për ta përjetësuar të vërtetën, për ta dokumentuar të vërtetën dhe për ta mundësuar e ndihmuar drejtësinë. Ky bashkëpunim është dëshmi e përkushtimit të përbashkët për ta mbrojtur kujtesën tonë kolektive”, ka pohuar Kurti, duke shtuar se në

raste si kjo, veçanërisht kujtojnë të gjithë ata të cilët sakrifkuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë. “Është detyra jonë morale dhe institucionale të sigurojmë që vuajtjet e tyre të mos harrohen kurrë. Është nderim e drejtësi ndaj atyre që kanë sakrifkuar për lirinë e Kosovës dhe ndaj familjeve që ende bartin dhembjen e të vvarëve dhe të të zhdukurve me dhunë gjatë luftës”, ka deklaruar Kurti.

Në këtë mbledhje në rend të ditës ishte edhe Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030.

Kurti ka thënë se me reformën që po bëjnë në sektorin e shëndetësisë, po sigurojnë qasjen e plotë për të gjithë qytetarët në shërbime shëndetësore cilësore e të sigurta, pa vështirësi financiare. “Në lidhje me këtë, ministri ynë i Shëndetësisë, Arben Vitia, gjithashtu do të jetë në konferencën për media pas përfundimit të kësaj mbledhje. E unë gjatë ditës, me kënaqësi do të marr pjesë në përfundimin e objektivit të ri të Urgjencës në komunën e Podujevës, që është rezultat i një pune të përbashkët dhe

bashkëfinancimit të komunës dhe Fondacionit Katar, me të cilin u takova para se të vij në këtë mbledhje”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se lufta kundër krimit të organizuar dhe kundër korrupsionit po fuqizohet me një ligj modern, që përcjellë standardet e Bashkimit Evropian kundër shpëlarjes së parave. “Andaj, në rend të ditës sot, po ashtu e kemi aprovimin e Projektligjit Kundër Shpëlarjes së Parave. Republika jonë kësaj e përmblush kushtin e fundit për aplikim për anëtarësim në Zonën e Vetme të Pagesave Evropiane apo SEPA (Single Euro Payments Area). Anëtarësimi i Kosovës në SEPA sjell përfitime të shumta për ekonominë tonë, duke përfshirë lehtësimin e transferove ndërkombëtare e ndërbankare dhe uljen e kostove të atyre transakcioneve si për qytetarët ashtu edhe për bizneset. Sipas një studimi të ‘German Economic Team’, anëtarësimi në SEPA qytetarëve tanë ua kursen rreth 55 milionë euro në vit, të cilat ishin shpenzime të mëhershme të transfereve ndërbankare e ndërkombëtare të parave”, ka thënë Kurti.

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Komisioni Evropian (KE) ka njoftuar për paketën e gjashtë të investimeve në kuadër të Planit të Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor, e cila pritet t'i grumbullojë 1.2 miliard euro për investime.

KE-ja tha se kjo paketë do të mbështesë tetë investime të reja kryesore në ujësjellëse dhe kanalizime, në trajtimin e ujërave të zeza dhe në transportin hekurudhor, si dhe në inovacionin në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Investimet do të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me partnerë nga Ballkani Perëndimor dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Paketa e investimeve prej 1.2 miliard eurosh përfshin 300 milionë euro grante të BE-së nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA III), kontribute shtesë dypalëshe nga vendet anëtare të BE-së dhe nga Norvegjia, kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe kontribute nga ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Sipas njoftimit, investimet e reja do të zhvillohen bazuar në tri prioritete të Planit të Investimit: Rindërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve në Mal të Zi dhe në Bosnjë-Hercegovinë; progresi në infrastrukturën hekurudhore në Korridorin 10, me lidhje të shpejtë ndërmjet Beogradit dhe Velika Plana, që mundëson qarkullim më të shpejtë të udhëtarëve dhe mallrave në rajon; si dhe mbështetje për sektorin e biznesit në rajon.

Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka theksuar me këtë rast se plani i investimit për Ballkanin Perëndimor në vlerë 30 miliardë euro është përmbushur me një paketë të re prej 1.2 miliard eurosh. "Kjo forcon lidhjet rajonale me infrastrukturë cilësore dhe na sjell më afër njëritjetrit, që është synimi ynë. Partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor po e ndërtojnë të ardhmen e tyre evropiane. Këto investime, bashkë me reformat e nevojshme dhe me qasjen në tregun tonë të përbashkët, do t'i përgatisin ekonomitë e partnerëve tanë për t'iu bashkuar bllokut", tha ajo.

Komisioni Evropian miratoi Planin e Investimit për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020, i cili përfshin periudhën 2021-2027. Kjo paketë synon ta nxisë rimëkëmbjen afatgjatë, ta përshpejtojë transformimin e gjelbër dhe digjital dhe ta inkurajojë bashkëpunimin dhe konvergencën rajonale me BE-në.

Plani mbledh deri në 3 miliardë euro investime, duke përfshirë 9 miliardë euro grante të BE-së nëpërmjet IPA III gjatë një periudhe shtatëvjeçare. Nga kjo shumë, 5 miliardë euro janë dedikuar përmes Planit të Investimeve Ekonomike për rajonin.

Deri më tani BE-ja ka miratuar programe për grumbullimin e deri në 17.5 miliardë euro investime në kuadër të Planit Ekonomik dhe Investimeve, duke përfshirë 5.4 miliardë euro në formën e granteve të BE-së.







# Retorika anti-Trump dhe manipulimi politik në Kosovë



Bekim ÇOLLAKU

Fitorja e presidentit Donald Trump në zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka ndezur një debat të ri në Kosovë. Të nxitur nga partia në pushtet, disa zëra qëllimshëm po përpiqen të ngrënë alarmin duke nxitur frikë se marrëdhëniet Kosovë - ShBA mund të përkeqësohen pas fitores së presidentit Trump. Përkrahësit e Kryeministrit Kurti janë përfshirë në një fushatë propagande, duke përhapur narracione se kinse rikthimi i presidentit Trump dhe ekipit i tij përbën një kërcënim për të ardhmen politike të Kurtit në Kosovë. Për më tepër, ata e paragjykojnë dhe cilësojnë administratën në ardhje si pro serbe. Si rrjedhojë, sipas logjikës dhe retorikës së tyre, vetëm një qeveri e drejtuar nga partia e Kurtit mund të mbrojë Kosovën nga një qasje e "ashpër" e administratës së re amerikane. Kjo retorikë nuk përkon askund me të vërtetën. Për më tepër, kjo qasje manipuluese mund të sjellë vetëm dëm për Kosovën, duke nxitur përçarjen e marrëdhënieve edhe ashtu të brishta të qeverisë aktuale të Kosovës me ShBA-në, me shtetin kyç për stabilitetin dhe sigurinë tonë dhe të rajonit. Pra,

kjo retorikë ka për qëllim të manipulojë elektoratin kosovar për t'i dhënë mbështetje partisë në pushtet, pa u brengosur se kjo mund të thellojë hendekun midis Kosovës dhe ShBA-së.

Ndërkohë që procesi elektoral i Kosovës po afrohet - zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë parashikuar për 9 shkurt 2025 - fushata propagandistike e partisë në pushtet po përqendrohet gjithnjë e më shumë në frikësimin dhe manipulimin e votuesve. Duke e paraqitur fitoren e presidentit Trump si një kërcënim për Kosovën, përkrahësit e Kurtit synojnë të krijojnë ndjesinë e pasigurisë dhe të mbajnë një elektorat të lidhur emocionalisht me partinë në pushtet. Ky është një manipulim që vetëm e ndan më tej popullin e Kosovës dhe e distancon atë nga demokracia e vërtetë. Politika e frikës është një qasje e gabuar, pasi nuk fokusohet në përmbushjen e interesave shtetërore të Kosovës, por në interesat e ngushta partiake. Partia në pushtet po ripërsërit narrativën e njëjtë të mashtrimit dhe viktimizimit, njësoj sikur para katër vitesh. Atëherë, njësoj sikur sot, ata akuzonin administratën e presidentit Trump dhe në veçanti të dërguarin e tij special ambasadorin Richard Grenell, kinse për ndërhyrje dhe rrëzimin e Kurtit nga pushteti. Një qasje e tillë ishte manipuluese atëherë ashtu siç është edhe sot. Prandaj, qytetarët e Kosovës nuk duhet të bien pre e këtij manipulimi përsëri.

Ky manipulim politik mund të ketë pasoja të rënda në planin

afatgjatë. Duke ushqyer ndjenjat anti-amerikane brenda shoqërisë kosovare, partia në pushtet po ndërton një narrativë që nuk është në përputhje me interesat e vendit. Ndërsa ShBA-ja ka qenë dhe mbetet mbështetësi më i madh i Kosovës, përpjekjet për të krijuar përçarje mes dy vendeve mund të dëmtojnë seriozisht pozicionin ndërkombëtar të Kosovës, dhe të pengojnë rrugëtimin e saj drejt integritimit në strukturat euro-atlantike.

Fitorja e Trump në zgjedhjet e fundit presidenciale amerikane nuk paraqet kërcënim për Kosovën. Përkundrazi, administrata e re mund të sjell mundësi pozitive të reja. Fundja, administratat amerikane, pavarësisht individëve që i kanë udhëhequr, kanë mbajtur një qëndrim të qartë për mbështetjen e Kosovës. Megjithatë, është e vërtetë se administrata Trump, në mandatin e saj të parë, ishte më pragmatike dhe synonte rezultate konkrete përmes diplomacisë ekonomike dhe marrëveshjeve të ndërsjella. Marrëveshja e Uashingtonit, e arritur në vitin 2020 midis Kosovës dhe Serbisë, ishte një shembull i përpjekjeve për të krijuar paqe dhe stabilitet përmes nxitjes së bashkëpunimit ekonomik. Në këtë kontekst, është thelbësore që qeveria e ardhshme e Kosovës të ndërtojë marrëdhënie të ngushta dhe pragmatike me administratën e presidentit Trump për të garantuar që Kosova të mos mbetet në një pozitë të pafavorshme ndërkombëtare. Një qasje e matur dhe strategjike në marrëdhëniet me ShBA-në,

është thelbësore për të ruajtur mbështetjen amerikane dhe për të avancuar pozicionin e Kosovës në skenën ndërkombëtare.

Kosova aktualisht ndodhet në një pozicion të vështirë ndërkombëtar. Për shkak të qasjes së vet-izolimit dhe përkeqësimit të marrëdhënieve me partnerët kryesorë perëndimorë, ajo është përballur me një izolim të pjesshëm nga proceset ndërkombëtare. Ky izolim i ka dëmtuar aspiratat për integritet në NATO dhe BE, duke bërë që Kosova të ngecë në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit në këto organizata. Prandaj, është e domosdoshme që çdo qeveri që do të zgjidhet pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 të punojë në mënyrë intensive dhe bashkëpunuese me administratën e re amerikane. Qeveria dhe populli amerikan mbetet duhet të vazhdojë të mbetet partner kyç për Kosovën. Vetëm përmes një bashkëpunimi të ngushtë me ShBA-në, Kosova mund të ketë një shans të vërtetë për t'u bërë pjesë e NATO-s dhe BE-së dhe për të arritur një stabilitet të qëndrueshëm. Në këtë aspekt, retorika anti-amerikane, e nxitur nga interesat e ngushta të partisë në pushtet, mund të jetë vetëm pengesë. Për të dalë nga izolimi, Kosova duhet të lërë mënjanë politikën populiste dhe të fokusohet në ndërtimin e një diplomacie të fuqishme dhe profesionale.

Për të siguruar që Kosova të dalë nga situata e ndërlikuar ndërkombëtare në të cilën ndodhet, është e domosdoshme që qeveria e ardhshme të vendosë

përpara interesin shtetëror mbi interesat partiake. Bashkëpunimi me ShBA-në nuk duhet të jetë vetëm një çështje e retorikës politike, por një realitet i përditshëm i qeverisë kosovare. Në vend të përhapjes së frikës dhe propagandës anti-amerikane, qeveria duhet të ndërtojë një strategji të bazuar në mirëbesim dhe bashkëpunim me aleatët ndërkombëtarë. Është koha që udhëheqësit e Kosovës të kuptojnë se mbështetja amerikane nuk mund të konsiderohet e garantuar. Ajo kërkon punë të vazhdueshme dhe angazhim në ndërtimin e partneriteteve strategjike. Pa një qasje të tillë, Kosova rrezikon të mbetet e izoluar dhe e marginalizuar, duke humbur përfundimisht shansin për t'u bërë pjesë e familjes euro-atlantike. Kjo kërkon një udhëheqësi të guximshme dhe të mençur, e cila është e gatshme të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të largojë narrativet që rrezikojnë të dëmtojnë interesat e Kosovës.

Në fund të fundit, e ardhmja e Kosovës qëndron në dorën e qytetarëve të saj. Ata duhet të jenë të informuar mirë dhe të jenë të kujdesshëm ndaj manipulimeve dhe retorikës së papërgjegjshme. Nëse Kosova dëshiron të sigurojë një vend të qartë në skenën ndërkombëtare, qeveria e ardhshme duhet të ndërtojë një diplomaci aktive, duke punuar në krah të aleatëve dhe partnerëve strategjikë, për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të suksesshme për të gjithë qytetarët e saj.

## FSK-ja validon me sukses Regjimentin e Dytë të Këmbësorisë në Ushtrimin Fushor "Ujku i Çeliktë"

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka realizuar Ditën e Vizitorëve të Shquar të ushtrimit fushor "Ujku i Çeliktë" si proces kulminant i një pune dyvjeçare në validimin e Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Bashkim Jashari, në këtë ushtrim priti presidenten Vjosa Osmani-Sadriu, kryeministrin Albin Kurti, ministrin e Mbrojtjes Ejup Maqedonci, komisionaren parlamentare të FSK-së, Remzije Zeqiraj, deputetët nga Komisioni Parlamentar për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, përfaqësues nga ambasadat e akredituara në vend, përfaqësues nga KFOR-i, atashë të mbrojtjes dhe përfaqësues ushtarakë nga vendet partnere.

Fillimisht gjeneral Jashari i njoftoi të pranishmit mbi të arriturat e FSK-së në përgjithësi dhe në veçanti mbi fazat në të



cilat ka kaluar Regjimenti i Dytë i Këmbësorisë për të arritur deri të validimi bazuar në misionin ushtarak në kuadër të Komandës

së Forcave Tokësore. Validimi i njësive është një proces i gjatë i planifikimit, trajnimit, stërvitjes së personelit dhe mbështetjes

logjistike me qëllim të realizimit të detyrave për përmbushje të misionit. Pastaj njësitë e dislokuara në

terren në kuadër të Ushtrimit Fushor "Ujku i Çeliktë" bën demonstrimin e operacioneve mbrojtëse, operacioneve sulmuese dhe kulminuan me operacionet e stabilitetit.

Në fund, presidentja Osmani-Sadriu dhe kryeministri Kurti iu adresuan ushtarakëve të FSK-së ku e përgëzuan gjeneral Jasharin dhe të gjithë ushtarakët e FSK-së për këtë arritje. Ata, gjithashtu, shprehën konsideratat më të larta mbi profesionalizmin, vendosmërinë dhe udhëheqjen e suksesshme të këtij procesi me rëndësi për mbrojtjen e territorit. Forca e Sigurisë së Kosovës, duke u bazuar në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, është duke ngritur kapacitetet operacionale të njësive bazuar në misionin e tyre. Andaj në kuadër të këtij ushtrimi janë validuar Regjimenti i Dytë i Këmbësorisë dhe Togu i Mbështetjes Luftarake të Policisë Ushtarake.



## KFOR-i patrullon në veri, pranë kufirit Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ushtarët e Komisionit të Zbatimit të Përbashkët të Komandës Rajonale Lindore të misionit KFOR kanë realizuar patrullime në veri të Kosovës, përgjatë kufirit me Serbinë, për të promovuar dhe siguruar një mjedis të sigurt dhe me lëvizshmëri të lirë për të

gjithë qytetarët e Kosovës, thuhet në njoftimin e tyre. “KFOR-i vazhdon ta zbatojë mandatin e tij bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999 për të kontribuar në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të sigurisë për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në

Kosovë, duke siguruar lëvizshmërinë e lirë në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme”, theksohet në njoftim. KFOR-i punon ngushtë me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit) në rolet e tyre si përgjegjës të sigurisë.



## Veli Bytyqi, kandidat i Nismës për deputet



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka paraqitur kandidatin e radhës për deputet në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, Veli Bytyqin. “Kam kënaqësinë të prezantoj Veli Bytyqin si kandidat për deputet të NISMA Socialdemokrate. Veli Bytyqi është një personalitet me një karrierë të gjatë si gazetar, publicist dhe aktivist në çështje të rëndësishme politike. Nga përgatitja akademike, ai është master në Shkencat e Komunikimit Masiv - Gazetari. Ka qenë gazetar shumëvjeçar në të përditshmen ‘Rilindja’ dhe ‘Bujku’, redaktor dhe zëvendëskryeredaktor, si dhe

kryeredaktor i kësaj gazete për shumë vite. Po ashtu, ka ushtruar detyrën e drejtorit të ‘Radio Rilindjes’, ka shkruar Limaj në ‘Facebook’. Ai ka thënë se Veliu ka qenë veprimtar i çështjes kombëtare para dhe pas luftës, si dhe aktivist në shumë procese të jetës politike, publike e shoqërore. “Ka qenë deputet në vitet ‘90 nga radhët e PSHDK-së. Aktivizmi i tij në çështje politike të hershme dëshmon angazhimin e tij të pandërprerë për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe forcimin e shtetit ligjor. Veliu dhe ekipi i NISMA-s garantojnë përkushtim dhe angazhim për vendin dhe, rrjedhimisht, sukcesi është i garantuar”, ka shkruar Limaj.

## Haziri: LDK-ja nuk e pranon draft-statutin e Asociacionit

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Nënkrjetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka thënë se partia e tij nuk e pranon draft-statutin e Asociacionit. “Marrëveshja e 27 shkurtit 2023 në Bruksel, e pasuar më 15 mars 2023, është marrëveshje e keqe”, ka thënë Haziri. “Në katër nene të saj ka problem serioze. Mbi të gjitha, draft-statutin evropian që quhet në terma, kjo qeveri nuk e miratoi përkundër premtimit. Është dokument të cilin LDK-ja nuk e kalon”, tha Haziri në Rubikon të Klan Kosovës. Haziri foli edhe rreth asaj se nëpër sa faza i është dashur të kalojë Kosova pas çlirimit nga okupimi serb, duke vënë në



pah se vendi ynë ka qenë i shkatërruar në plot aspekte. “Masat, sanksionet dhe krejt

ato detyrime që shqiptarët e Kosovës i kanë pasur, edhe me largime nga puna, edhe me

marrje të së drejtës së punës dhe të drejtave elementare civile e politike në atë kohë.

Tash me fol 25 vjet pas luftës e 16 vjet pas pavarësisë për diçka që është rifilluar, është rindërtuar dhe është zhvilluar në parametra krejt të tjerë, pa e përmendur administrimin ndërkombëtar 8 vjet të plota dhe 3 vjet mbikëqyrje ndërkombëtare, dhe pastaj procesi si i tillë i transformimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike e komunale me vështirësitë e veta që i ka pasur, me mënyrën dhe formën që politika dhe ligjet në Kosovë e kanë vendosur me kohë se si të transformohet dhe cili është modeli i privatizimit dhe privatizimeve në Kosovë, është përtej asaj me e quajft budallaki politike”, ka thënë Haziri.

## Ministri Krasniqi informohet për projektin “Nisma për të drejtën e pronës (NDP)”

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Përfaqësuesit e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) mbajtën takim me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, për ta informuar lidhur me projektin “Nisma për të drejtën e pronës (NDP)”, i cili

përfshin 28 komuna të Kosovës. Drejtori ekzekutiv i Institutit KLGJ, Valmir Gashi, menaxherja e programit në KLGJ, Jona Jaha, menaxherja e projektit PIAKOS, Odeta Naks dhe specialistja e komponentit dhe raportimit në projektin PIAKOS, Mimoza Janova, prezantuan zhvillimin dhe rëndësinë e projektit për

përmirësimin e qasjes në informacion për regjistrimin e tokës dhe pronës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të këshillimit për të drejtat pronësore, me fokus gratë, të rinjtë dhe komunitetet pakicë. Projekti zbatohet nga ATRC, bashkëzbatohet nga KLGJ dhe financohet nga Banka Botërore/Fondi për Paqe dhe Shtetndërtim.





## Hamza takon Shoqatën e Bizneseve në Prizren: Do ta heqim pagesën në kufi për TVSh-në

PRIZREN, 13 NËNTOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër, Bedri Hamza, ka takuar përfaqësuesit e bizneseve në Shoqatën ESNAF në Prizren, me të cilët ka diskutuar për programin ekonomik dhe lehtësirat në të bërit biznes në vend.

Hamza u premtoi atyre se shqetësimin e kamotshëm të

bizneseve, praktikën e pagesës së TVSh-së në kufi, do ta ndryshojë gjatë qeverisjes së tij. "Shqetësimin e kamotshëm të bizneseve, praktikën e pagesës së TVSh-së në kufi, u premtova se do ta ndryshojmë edhe përfaqësuesve të Shoqatës ESNAF në Prizren. Bizneset nuk do të detyrohen t'i paguajnë në avanc obligimet

e tyre, por do t'u krijohen mundësi të zhvillohen dhe t'i kryejnë obligimet tatimore kur t'i shesin produktet e tyre. Këtë barrë tatimore do t'ua heqim të gjitha bizneseve që importojnë në Kosovë. Kosova mundet ma mirë për ekonominë, për bizneset dhe të gjithë punëtorët e sektorit privat e publik në vendin tonë!", ka thënë Hamza.



## ZRRE-ja merr vendim që për sezonin 2024/2025 konsumatorët do të paguajnë njëjtë për ngrohje

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryetari i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRRE), Ymer Fejzullahu, ka deklaruar se edhe për sezonin 2024/2025 konsumatorët do të paguajnë njëjtë për ngrohje. Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se ky vendim është marrë në mbledhjen e 11-të të Bordit të ZRRE-së, në të cilën është theksuar se edhe faturimi i ngrohjes sipas konsumit do të ndikojë në kursim të energjisë elektrike. "Tarifat do të mbesin të njëjta, por ajo çfarë është më rëndësi është faturimi me matje e mundëson që

konsumatorët të kursejnë energji elektrike dhe të njëjtën kohë të ulen faturat e tyre", tha ai.

Fejzullahu shpreston që edhe në vitin e ardhshëm konsumatorët e tjerë të përshihen në faturimin e ngrohjes sipas konsumit.

Po në mbledhjen e mbajtur të martën, bordi i ZRRE-së aprovoi çmimin maksimal për ankandin e erës. "Ndër pikat me rëndësi që është diskutuar është edhe përcaktimi i çmimit maksimal për 75 MW, kapacitet me energji nga turbinat e erës për të cilën pritet të



organizohet ankandi nga ana e ministrisë. ZRRE ka përcaktuar çmimin maksimal apo çmimin që janë të gatshëm ta paguajnë konsumatorët në tarifat e energjisë elektrike, nëse kemi ofertues të përgjegjshëm, ku është përcaktuar të jetë 80.2 euro për megavat", tha Fejzullahu.

Zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike ndër pikat e tjera të rendit të ditës ka aprovuar edhe sasinë e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare Shqipëri - Kosovë për procesin e Bashkimit të Tregjeve në vlerë prej 50 megavatesh.

## Masa 2.2 në mbështetje të bizneseve për qasje në financa, qeveria ndan rreth 7 milionë euro për sektorin privat

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Masës 2.2 e cila është për "Mbështetje bizneseve për qasje në financa të pakos së ringjalljes ekonomike (MEPT)".

Gjatë mbledhjes së Qeverisë së Kosovës kryeministri Albin Kurti ka thënë se ndarja e mjeteve buxhetore është mbi 7 milionë euro. "Ministria e Financave ka sjellë për aprovim vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej 7 milionë e 368 mijë e 410 eurosh për zbatimin e masës 2.2 për mbështetje të bizneseve për qasje në financa të pakos së ringjalljes ekonomike", ka thënë Kurti.

Ministri i Financave, Hekuran



Murati ka thënë se si qeveria kanë mbështetur Fondin për garancitë kreditore për ta

shtuar kapitalin. "Në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme që kemi për sektorin privat për

zhvillimin e ekonomisë së vendit në mënyrë të qëndrueshme, ne si qeveri kemi

mbështetur Fondin për garancitë kreditore për ta shtuar kapitalin në vazhdimësi, pra për të mbuluar apo financiar dritaret e ndryshme që janë në kuadër të këtij fondi", ka thënë Murati.

Sipas tij, kjo po bëhet për të ofruar garanci për bizneset në mënyrë që të mos kenë nevojë të ofrojnë hipoteka. "Në mënyrë që të vazhdojë rritja e garantimit të kredive që bizneset dhe ekonomia e vendit të kenë qasje më të lehtë në financa, duke mos pasur nevojë që të ofrojnë hipoteka si garanci apo pengje të tjera, ne do të vazhdojmë edhe me transferin e radhës që është në vlerë prej 7 milionë 368 mijë e 410 eurosh në kuadër të masës 2.2", ka thënë Murati.

## Bie importi i grurit

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ministria e Bujqësisë ka njoftuar se në vlerë prej 8.1 milionë eurosh ka rënë importi i grurit për 9 muaj të këtij viti krahasuar me vitin paraprak si rezultat i përkrahjes qeveritare. "Për vitin 2024 kemi rënie të dukshme në importin e grurit krahasuar me vitin e kaluar. Në vitin 2023 importuam 99.6 milionë kg grurë me një vlerë


prej 22.5 milionë euro; Në vitin 2024, ky tregues ra në 72 milionë kg, me një vlerë prej 14.4 milionë euro; Diferenca në sasi është 28 milionë kg më pak krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa në vlerë është 8.1 milionë euro më pak", ka njoftuar Ministria e Bujqësisë, duke theksuar se ky është rezultati i mbështetjes qeveritare. "Vetëm për një

produkt, grurin në këtë rast duke shënuar zvogëlim të konsiderueshëm të importit si në sasi, ashtu edhe në vlerë, një shenjë e një tregu që po krijon mundësi për përmirësim të balancit tregtar dhe mbështetje për prodhimin vendor, ndërsa eksporti i prodhimeve bujqësore, ka shënuar rritje", ka njoftuar Ministria e Bujqësisë.





# A duhet të shqetësohemi për ndjenjat e inteligjencës artificiale?



Nga: Anjana AHUJA  
/ The Financial Times

Të shumtën e herëve, si rrezik ekzistencial për Homo Sapiensin trajtohet debati nëse inteligjenca artificiale do të arrijë apo do të tejkalojë inteligjencën njerëzore. Fjala është për një ushtri robotësh që rebelohet, në stilin e Frankensteinit, dhe sulmon krijuesit e vet. Sistemet autonome të inteligjencës artificiale [AI] që menaxhojnë në heshtje çështjet qeveritare dhe të korporatave, llogaritin se një ditë bota do të funksiononte më mirë nëse njerëzit përjashtohen nga proceset.

Sot, filozofët dhe studiuesit e inteligjencës artificiale po pyesin: a do të zhvillojnë këto makina aftësinë për të ndier mërzë apo dhembje? Në shtator, kompania e IA-së, Anthropic, emëroi një studiues për “mirëqenien e IA-së”, për të vlerësuar, ndër të tjera, nëse sistemet e tij po i afrohen ndërgjegjes ose brengës dhe, nëse po, a duhet të merret parasysh mirëqenia e tyre. Javën e kaluar, një grup ndërkombëtar studiuesish publikoi një raport mbi këtë çështje. Sipas tyre, zhvillimi i

shpejtë teknologjik krijon një “mundësi reale që disa sisteme të IA-së të jenë të vetëdijshme dhe/ose të kenë brengë të forta, duke u bërë kështu moralisht të rëndësishme në të ardhmen e afërt”.

Ideja e shqetësimit për “ndjenjat” e AI-së mund të duket e çuditshme, por zbulon një paradoks në thelbin e garës për IA: kompanitë po garojnë për të krijuar sisteme artificiale që janë më inteligjente dhe më të ngjashme me ne, ndërsa në të njëjtën kohë shqetësohen që këto sisteme do të bëhen tepër inteligjente dhe tepër të ngjashme me ne. Duke qenë se nuk e kuptojmë plotësisht se si lind ndërgjegjja apo ndjesia për veten në trurin njerëzor, nuk mund të jemi plotësisht të sigurt se ajo nuk do të shfaqet kurrë në sistemet artificiale. Ajo që duket e jashtëzakonshme, duke pasur parasysh ndikimet e thella që mund të ketë për specien tonë krijimi i “mendjeve” digjitale, është se nuk ka më shumë mbikëqyrje të jashtme për drejtimin që po marrin këto sisteme.

Raporti me titullin Të marrim seriozisht mirëqenien e IA-së është shkruar nga studiuesit e Eleos AI-së, një institut që heton “ndjeshmërinë dhe mirëqenien e IA-së”, së bashku

me disa autorë të tjerë të njohur, si filozofi David Chalmers nga Universiteti i Nju-Jorkut, i cili argumenton se botët virtuale janë botë të vërteta, dhe studiuesi Jonathan Birch nga Shkolla Ekonomike e Londrës (LSE), libri i fundit i të cilit, Kufiri i ndjeshmërisë [The Edge of Sentience], ofron një kornizë për të menduar rreth mendjeve të kafshëve dhe të IA-së.

Raporti nuk pretendon se ndjeshmëria (aftësia për të pasur ndjesi si dhimbja) apo ndërgjegjja e IA-së është e mundshme ose e afërt, por vetëm se “ka pasiguri të madhe për këto mundësi”. Ata bëjnë paralele me injorancën tonë historike mbi statusin moral të kafshëve jonjerëzore, gjë që mundësoi feramat industriale; vetëm në vitin 2022, me ndihmën e punës së Birchit, gaforret, karavidhet dhe oktapodët u mbrojtën sipas Aktit të Mirëqenies së Kafshëve (Ndjeshmëria) në Mbretërinë e Bashkuar.

Ata paralajmërojnë se intuited njerëzore është një udhëzues i dobët: specia jonë është e prirur si ndaj antropomorfizmit që ua atribuon cilësitë njerëzore jonjerëzorëve që nuk i kanë ato, ashtu edhe ndaj



antropodenializmit që ua mohon cilësitë njerëzore jonjerëzorëve që ato i kanë.

Raporti rekomandon që kompanitë ta trajtojnë seriozisht çështjen e mirëqenies së IA-së; që studiuesit të gjejnë mënyra për të hetuar ndërgjegjen e IA-së, duke ndjekur shembullin e shkencëtarëve që studiojnë kafshët jonjerëzore; dhe që politikëbërësit të fillojnë të konsiderojnë idenë e një IA-je të ndjeshme ose të vetëdijshme, madje të mbledhin asamblëtë qytetare për të eksploruar këto çështje. Këto argumente kanë gjetur mbështetje në komunitetin e kërkimeve tradicionale. “Mendoj se nuk ka shumë gjasa për ndërgjegje të vërtetë artificiale, por kjo nuk është e pamundur”, thotë Anil Seth, profesor i neuroshkencës kognitive dhe llogaritëse në Universitetin e Saseksit dhe studiues i njohur i ndërgjegjes. Ai beson se ndjenja jonë për veten është e lidhur me biologjinë tonë dhe është më shumë se thjesht një llogaritje. Por, nëse ai e ka gabim, siç pranon se mund të ketë, pasojat mund të jenë të mëdha: “Krijimi i një IA-je të ndërgjegjshme do të paraqiste një katastrofë etike, pasi kështu

do të fusnim në botë format e reja të subjekteve morale dhe – potencialisht, në shkallë industriale – forma të reja vuajtjesh”. Askush, shton Sethi, nuk duhet të përpiqet të ndërtojë makina të tilla.

Iluzioni i ndërgjegjes duket si një shqetësim më i afërt. Në vitin 2022, një inxhinier i Google-it u pushua nga puna pasi tha se besonte që chatboti i IA-së i kompanisë shfaqte shenja ndjeshmërie. Anthropic-u ka qenë duke “trajnuar karakterin” e modelit të saj të madh gjuhësor për t’i dhënë tipare të të menduarit. Ndërsa gjithnjë e më shumë makinat, dhe veçanërisht modelet e mëdha gjuhësore (LLM), krijohen për t’u bërë më të ngjashme me njerëzit, rrezikojmë të mashtrohemi në shkallë të gjerë nga ato kompani që kanë pak kufizime dhe kontrole. Rrezikojmë të brengosemi për makinat që nuk mund të na përgjigjen, duke devijuar burimet tona të kufizuara morale nga marrëdhëniet që kanë rëndësi. Intuited ime e papërsosur njerëzore shqetësohet më pak për mendjet e IA-së që fitojnë aftësinë për të ndier – dhe më shumë për mendjet njerëzore që humbasin aftësinë për t’u brengosur. /Telegrafi/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Jashari dhe Emërllahu: Mund ta mposhtim Rumaninë

**EPOKA ENJTE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të mërkurën e ka zhvilluar stërvitjen e tretë dhe të fundit para udhëtimit drejt Rumanisë, ku e zhvillon ndeshjen kryesore për këtë edicion në Ligën e Kombeve më 15 nëntor në orën 20:45. Futbollistët "dardanë" punuan me përkushtim të lartë, ndërsa përzgjedhësi Franco Foda dhe stafi i tij e orientuan stërvitjen kryesisht në detaje taktike, duke synuar përmirësimin e skemave të lojës për përballjen e së premtës. Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se në seancën e fundit mungoi Donat

Rrudhani, i cili pësoi lëndim në stërvitjen e ditës së martë dhe pas ekzaminimeve mjekësore u lirua nga grumbullimi. Përkundër mungesave të rëndësishme si pasojë e lëndimeve, atmosfera brenda kampit të dardanëve mbetet pozitive dhe optimiste. Pas kësaj stërvitje, Muharrem Jashari ka shprehur optimizëm se "dardanët" mund ta fitojë ndeshjen që do të zhvillohet në Bukuresht. "Atmosfera është shumë e mirë, me një energji shumë të mirë, me një pozitivitet prej krejt lojtarëve. Përgatitjet po shkojnë shumë mirë dhe besoj shumë që në Bukuresht do ta arrijmë fitoren. Jemi duke u përgatitur maksimalisht taktikisht dhe normalisht që



jemi duke i shikuar pikat e forta, po ashtu edhe të dobëta të Rumanisë. Mendoj se në këtë ndeshje do të ballafaqohemi me një ekip shumë të mirë, siç e ka

Rumania, por besoj shumë që do ta arrijmë fitoren", ka thënë Jashari. Ndërsa mesfushori Lindon Emërllahu ka bërë me dije se, pavarësisht kundërshtarit të

fortë, Kosova në këtë ndeshje do të luajë vetëm për fitore. "Besoj që atmosfera është mjaft e mirë në ekip. Siç po e shihni edhe ju, jemi përgatitur mjaft mirë për këtë ndeshje. Secili lojtar e di rëndësinë e kësaj ndeshjeje dhe besoj që do të futemi në lojë vetëm për tri pikë. E dimë që Rumania e ka një ekip mjaft të mirë dhe është në vend të parë. Po ashtu, ne nuk kemi frikë nga asnjë ekip. E kemi një ekip mjaft të mirë dhe do të hyjmë vetëm për fitore", ka thënë Emërllahu.

Ekspedita e Kosovës udhëton sot (e enjte) në mesditë drejt Bukureshtit, ku do të zhvillohet përballja me Rumaninë të premtën, më 15 nëntor.

## Çeku: Vitin e ardhshëm nis ndërtimi i Stadiumit Nacional



**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se ndërtimi i Stadiumit Nacional të Kosovës do të nisë vitin e ardhshëm dhe se për këtë tashmë po negociohet marrja e një kredie ndërkombëtare që do të përdoret për ndërtimin e tij. "Aktualisht bashkë me Ministrinë e Financave, po bëjmë negocimin e kredisë ndërkombëtare. Në momentin që do ta kemi marrëveshjen për kredi ndërkombëtare, e njëjta procedohet në Kuvend për ratifikim dhe presim që në pjesën e dytë të vitit të ardhshëm t'i nisim punimet edhe për ndërtimin e Stadiumit Nacional të Kosovës", ka thënë

Çeku. I pari i MKRS-së ka folur edhe për bashkëpunimin e Shqipërisë me Serbinë për organizimin e Kampionatit Evropian të grupmoshave U21 në vitin 2017. Ai theksoi se nuk ka pasur fare komunikim me Shqipërinë për mundësinë që ky kampionat të organizohet në një bashkëpunim Shqipëri - Kosovë. "Faktet duhen thënë, ne si ministri nuk jemi kontaktuar asnjëherë në raport me mundësinë e bashkëpunimit të këtij kampionati. Pra ne kemi kuptuar që një gjë e tillë po ndodh në momentin kur është publikuar aplikimi i përbashkët i Shqipërisë me Serbinë për ta

organizuar këtë kampionat. Fatkeqësisht, pas kritikave që kanë marrë, nga Federata e Shqipërisë është thënë që Kosova nuk është gati me infrastrukturë. Kjo nuk qëndron. Shumë shpejt vendin tonë e bëjmë lider në rajon për infrastrukturën e futbollit. Deri në vitin 2027 ne do t'i kishim të përfunduara mjaftueshëm stadione që këtë kampionat ta bashkorganizojmë me Shqipërinë", ka shtuar Çeku, i cili ka folur edhe për stadiumin e qytetit në Gjiilan, për të cilin ka thënë se është në procedurë të vlerësimit për shpalljen e operatorit për ndërtimin e këtij stadiumi në vlerë prej 15 milionë eurosh.

## Drejtuesit e FFK-së dhe futbollistët 'dardanë' vizitojnë SOS Fshatin, dhurojnë mijëra euro donacion

**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Përfaqësues të Federatës së Futbollit të Kosovës, në krye me kryetarin Agim Ademi dhe përzgjedhësin Franco Foda, së bashku me lojtarët Edon Zhegrova, Florent Muslija dhe Arijanet Muriq, kanë vizituar SOS Fshatin e Fëmijëve në Prishtinë. Përveç takimeve me fëmijë, kanë ndarë edhe një shumë parash si donacion. Sipas faqes zyrtare të SOS-it, fshati gumëzhinte nga zhurma e fëmijëve që vraponin për t'i përqaftuar yjet e Kombëtares së Kosovës në futboll dhe për të

biseduar me ta, teksa pyetjet nuk kishin të sosur. Në SOS Fshat gjendet një djalosh i talentuar me emrin Dreni, i cili është i apasionuar pas futbollit dhe ëndërron të luajë për Barcelonën. Ai kishte një pyetje të veçantë për Edonin: donte të dinte me kë ëndërron Zhegrova të luajë, dhe Edoni iu përgjigj se ëndërra e tij është të luajë në një ekip me Messin. Përveç Zhegrovës, Edoni kishte pyetje edhe për gardianin e portës së Kosovës, Muriq, i cili u pyet nëse kishte menduar ndonjëherë të luajë basketboll.



Dreni kishte sjellë me vetë edhe topin e tij të vjetër të futbollit, të cilin Zhegrova, Muriqi dhe Muslija e nënshkruan, që ta ketë si kujtim të kësaj dite. Aty nuk mungoi as loja e futbollit, ku talenti i fëmijëve të SOS Fshatit në Prishtinë i la të gjithë të habitur. Në fund, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, njoftoi se FFK së bashku me Muslijën, Muriqin dhe Zhegrovën do të dhurojnë 4 000 euro për fëmijët e SOS Fshatit, një kontribut i jashtëzakonshëm për rritjen dhe mirëqenien e tyre.



## Curry mund i vetëm Dallasin, Detroiti triumfon pas kohës shtesë, bien kampionët e Bostonit

**BOSTON, 13 NËNTOR** - Fitore në sekondat e fundit për Atlantan, që mundi me rezultat 117-116 kampionët e Boston Celticsit. Një ndeshje e ekuilibruar, ku për miqtë u dallua Dayson Daniles, autor i 28 pikëve. Për Celticsin, Browni realizoi 37 pikë e White 31, por që

s'mjaftuan për të fituar. Pas kohës shtesë triumfoi skuadra e Detroitit, që mundi me rezultat 123-121 Miamin, sfidë spektakolare deri në fund. Për Miamin u dallua Herro me 40 pikë, por që mbetën për statistikë, ndërkohë që kolektiviteti ishte arma e fortë e

Pistons. Fitore të rëndësishme korri Milwaukee, që mundi me rezultat 99-85 Toronton dhe i largohet fundit të renditjes. Antetokounmpo me 23 pikë ishte lider për Bucksin. Ekipi i Golden States, falë 37 pikëve të Stephen Curryt, mundi me rezultat 120-117 Dallasin.

Rezultatet: Boston - Atlanta (116-117), Detroit - Miami (123-121), Orlando - Charlotte (114-89), Philadelphia - New York (99-111), Milwaukee - Toronto (99-85), Utah Jazz - Phoenix (112-120), Golden State - Dallas (120-117), Portland - Minnesota (122-108).



## Ramadani: Duam rezultat pozitiv ndaj Çekisë, jap gjithçka për këtë fanellë

**TIRANË, 13 NËNTOR** - Në konferencën për medie të mërkurën, tri ditë përpara sfidës së parafundit në Grupin B1 të Ligës së Kombeve, ishin të pranishëm dy futbollistët e kombëtares sonë, sulmuesi Indrit Tuci si dhe mesfushori i Lecces, Ylber Ramadani. Ramadani, lidhur me dy ndeshjet e fundit të ekipit kuqez, u shpreh: "Të dyja kundërshtarët janë të forta, por ne po mendojmë njëherë për Çekinë dhe pastaj për Ukrainën. Po përgatitemi si të luajmë kundër tyre. Kemi avantazh tifozët tanë që janë një shtysë e madhe për ne. Në futboll funksionon ndeshje pas ndeshje, presion ka gjithmonë, por duhet të dimë ta përballojmë. Ndeshjen atje e humbëm prej dueleve dhe topave të gjatë, por këtu duhet të jetë diçka tjetër. Unë me këdo që të luaj ambientohem



shpejt. Unë mund të rri dhe mbrapa për ta ndihmuar mbrojtjen. E di trajneri për mënyrën e vendosjes në fushë. Nuk lodhem asnjëherë, por ata që më ndihmojnë është mirë dhe jap gjithçka për të luajtur më mirë". "Nuk i shikoj statistikën, por vetëm analizën e trajnerit. Nuk kam kohë për t'i shikuar. Sulmuesi i Çekisë

është shumë i gjatë dhe duhet ta mbulojmë dy veta. Është i fortë fizikisht. Ai e bën gjithë lojën e Çekisë. Të gjithë që kemi ardhur këtu duam që t'i marrim rezultatet pozitive. Do ta bëjmë maksimumin për t'i marrë fitore. Do ta ndryshojmë qasjen dhe përkushtimin në ndeshje", ka deklaruar Ramadani.

## Tuci: Çekia është e fortë fizikisht

**TIRANË, 13 NËNTOR** - Tri ditë përpara sfidës së parafundit në Grupin B1 të Ligës së Kombeve, sulmuesi Indrit Tuci, që është pjesë e Spartës së Pragës, lidhur me dy ndeshjet e fundit të Shqipërisë, u shpreh: "Nuk kam presion, por me qejf pasi është hera ime e parë që do të luaj në Air Albania dhe do të jetë sold-out. E marr më shumë si tip motivimi dhe jo presioni. Unë jam gjithmonë i gatshëm për të dhënë më të mirën. I njoh mirë çekët, se kanë një stil loje me topa të gjatë dhe fizikisht të fortë. Duhet t'i mbulojmë sa më mirë dhe t'i neutralizojmë, dhe t'i kënaqim tifozët. Besoj se jam gati, se kam bërë të gjithë kontrollet. Më kanë dalë me sukses. Këtu jemi për Kombëtaren dhe duhet të japim gjithçka. S'mund të them që janë pak 3 gola në 4 ndeshje. Ne kemi 6 pikë, aq sa kanë dy skuadra të



tjera. Ne të gjithë duam të shënojmë gol, por do t'ia dalim me sukses, se po stërvitemi mjaft mirë". "Kam ardhur këtu për të dhënë më të mirën. Këtu është ndryshe se me klubin. Aq sa do të futesh në fushë ta japësh

maksimumin. Unë luaj me qendërmbrojtësin e Çekisë, por u dëmtua dhe më vjen mirë që s'do të luaj kundër nesh. Çdo ditë e mendoj golin dhe si mund ta shënosh, por dua ta ndihmoj ekipin", ka deklaruar Tuci.

### SHKURT

#### Gjilani jep njoftim për tre futbollistët e lënduar

SC Gjilani njofton se futbollistët Robert Rrahmani, Edison Kqiku dhe Eldonit Shaqiri kanë përfunduar ekzaminimet e fundit mjekësore. Rrahmani në ndeshjen e fundjavës ndaj Suharekës ka marrë një goditje dhe për pasojë ka çarje në pjesën e jashtme të buzës së poshtme, por gjendja e Rrahmanit është stabile dhe futbollisti pritet të jetë i gatshëm në seancën e radhës stërvitore pas ditëve të dhëna të lira nga stafi teknik. Ndërsa kapiteni i skuadrës, Edison Kqiku, kishte ndër një shqetësim në muskulin e këmbës së majtë gjatë seancave stërvitore dhe, pas ekzaminimeve të fundit, është vërtetuar se ai do të jetë i gatshëm për të marrë pjesë në ndeshjet e radhës. Futbollisti i tretë, Eldonit Shaqiri, gjithashtu është i hospitalizuar, kurse periudha e rikthimit të tij në aktivitet do të vlerësohet pas kontrolleve të radhës.

#### Roma, afër marrëveshjes me Ranierin

AS Roma është ende në kërkim të trajnerit të ri. Emri i ri, që tashmë duket një hap larg zyrtarizimit, është ai i Claudio Ranierit. Trajneri i njohur italian vjen i pari në preferencat e Friedkings. Ranieri është nisur drejt Londrës (së bashku me agjentin Chiodi) për t'i takuar pronarët e Romës: në këtë pikë ai është kandidati i fortë për ta marrë stolin verdhekuq, me Montellën dhe Mançinin që kanë humbur pozicione. Ranieri është gati t'i thotë po Romës për aventurën e tij të tretë në stolin verdhekuq, pas eksperiencave të mëparshme, fillimisht midis viteve 2009 dhe 2011, dhe më pas në muajt e fundit të sezonit 2018/19. Në orët në vijim pritet që të vijë edhe njoftimi zyrtar i Romës në lidhje me trajnerin e ri.

#### Inter Miami dështoi në MLS, Messi: Rikthehem më të fortë sezonin tjetër

Inter Miami u eliminua në fazën "play-off" në kampionatin amerikan, duke zhgënjyer kështu tifozët. Në një postim në rrjetet sociale, Lionel Messi falënderoi tifozët për mbështetjen, ndërsa premtoi se skuadra do të rikthehet më të fortë në sezonin tjetër. "Edhe pse arritëm disa objektiva, ne donim më shumë. Faleminderit të gjithë tifozëve që na mbështetën! Tani përgatitemi të kthehem më të fortë vitin e ardhshëm", ka shkruar Messi.

#### Rodri: Vetëm Haalandi mund të afrohet me Messin dhe Ronaldon

Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo kanë dominuar në futbollin botëror prej vitesh, duke fituar së bashku 13 "Topa të Artë". Fituesi i fundit i "Topit të Artë", Rodri, ka folur për këtë dyshe dhe mendon se vetëm Erling Haaland mund t'i afrohet atyre nga cilësia. Rodri ka folur për bashkëlojtarin e tij në Manchester City, Erling Haaland, duke thënë se ai është i vetmi lojtar që mund të afrohet me Lionel Messin ose Cristiano Ronaldon. "Lojtari më vendimtar në botë për sa iu përket numrave është Erling Haaland", ka thënë mesfushori spanjoll. "Ai është i vetmi lojtar që mund të afrohet me Leo Messin dhe Cristiano Ronaldon. Haaland është gjithashtu shumë i ri dhe do të jetë duke dominuar futbollin për shumë vjet", ka deklaruar fituesi i "Topit të Artë".

## Formula 1, me risi në 75-vjetorin e garave

Formula 1 vazhdon ta ndjekë rrugën e spektaklit dhe këtë gjë dëshiron ta tregojë edhe jashtë pistës. Drejtuesit e saj, së bashku me ata të FIA-s, kanë njoftuar një risi interesante, që do të aplikohet vitin tjetër.


Makinat do të prezantohen të gjitha në të njëjtën ditë. Festa e madhe e organizuar nga Formula 1 do të zhvillohet më 18 shkurt 2025, në stadiumin "O2 Arena" të Londrës. Kjo risi do të bëhet për ta festuar 75-

vjetorin e F1. Kështu, mbrëmjen e 18 shkurtit do të prezantohen dhjetë skuadrat së bashku me drejtuesit dhe pilotët e tyre përkatës. Kjo bëhet edhe për t'i eliminuar prezantimet "fake" të sezoneve

të fundit. "Për herë të parë do të mbledhim fansat tanë, të 20 pilotëve e sportit tonë dhe disa të ftuar shumë specialë për ta nisur zyrtarisht sezonin e ri dhe për ta festuar vitin tonë të 75-të të garave", deklaroi Stefano

Domenicali. Më tej, presidenti i Formulës 1 shtoi: "Kjo do të jetë një mundësi fantastike për tifozët e të gjitha moshave që të përjetojnë nga afër spektaklin e pabesueshëm të argëtimit që është F1".





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS  
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA  
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Prishtinë, 14.11.2024

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimor-shkencor (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024 për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L212, vendimit nr.67/24, të datës 13.11.2024 Këshilli Shkencor i Institutit, shpallë:

## KONKURS

### për ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE - AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE TË HULUMTUESVE

1. 2 (Dy) bashkëpunëtor shkencor, prej të cilëve:
  - 1.1. 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për tekste shkollore dhe mjete mësimore;
  - 1.2. 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi;

#### Përshkrimi i punëve për pozitën 1.1.

- Harton projekte kërkimore – shkencore nga fusha përkatëse;
- Bën analiza, vlerësime dhe hulumtime në fushën teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore;
- Bën hulumtime për përshtatshmërinë e teksteve shkollore për nivelin e arsimit parauniversitar;
- Organizon debate profesionale lidhur me përshtatshmërinë e teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore;
- Punon në mënyrë të pavarur në hulumtimet shkencore të aprovuara nga organi përkatës, sipas planit të miratuar;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushëveprimtaria e departamentit/divizionit përkatës;
- Kryen punë në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese – shkencore në fushën e teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore;
- Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve kërkimore – shkencore në Institut;
- U ndihmon punonjësve shkencor dhe profesional në kryerjen e detyrave të tyre;
- Harton planin e punës për aktivitetet vjetore, individuale dhe ato të departamentit/divizionit;
- Shkruan recensionet dhe vlerësim sipas kërkesës së Institucionit;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

#### Përshkrimi i punëve për pozitën 1.2.

- Harton projekte kërkimore – shkencore nga fusha përkatëse e gjuhës shqipe dhe komunikimit;
- Kryen studime shkencore në fushën e kurrikulave të gjuhës shqipe dhe të komunikimit;
- Realizon studime shkencore për metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- Bën studime shkencore në fushën e mësimdhënies, të nxënies dhe vlerësimit në lëndët e gjuhës dhe të letërsisë;
- Bën analiza për zhvillimin profesional të mësimdhënësve të fushës kurrikulare të gjuhëve dhe komunikimit;
- Bën studime në fushën e kurrikulave lëndore dhe përmbajtjeve mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë në arsimin gjithëpërfshirës;
- Realizon studime shkencore në lidhje me testimet ndërkombëtare në fushën e kulturës së leximit;
- Punon në mënyrë të pavarur në hulumtimet shkencore të aprovuara nga organi përkatës, sipas planit të miratuar;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushëveprimtaria e departamentit/divizionit përkatës;
- Kryen punë në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese – shkencore në fushën e kulturës së leximit;
- Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve kërkimore – shkencorë në Institut;
- U ndihmon punonjësve shkencor dhe profesional në kryerjen e detyrave të tyre;
- Harton planin e punës për aktivitetet vjetore, individuale dhe ato të departamentit/divizionit;
- Shkruan recensionet dhe vlerësim sipas kërkesës së Institucionit;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

#### Kandidati për bashkëpunëtor shkencor duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë shkallën e doktorit të shkencave;
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare. Punimet duhet të jenë të njohura sipas rregullores në fuqi;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit, nga fusha përkatëse;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitetet shkencore e profesionale nga fusha e kërkimit dhe konkurs;
- Të ketë të botuar monografi shkencore nga fusha përkatëse.

#### Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (doktoratës);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dëshmi të lëshuar nga Gjykata kompetente, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar;
- CV-në e përditësuar, së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Listën e botimeve në revista ndërkombëtare të njohura sipas rregullores në fuqi duke evidentuar: autori/ët, titulli i punimit, revista, numri dhe/apo vëllimi i botimit si dhe linku i indeksimit me numër DOI (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Listën e botimeve në revista tjera, vendore e ndërkombëtare duke evidentuar: autori/ët, titulli i botimit, lloji i botimit, botuesi dhe vegëza e botimit me <https://www...> (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Dëshmi tjera për të arriturat shkencore e profesionale si: artikuj, libra, monografi, konferenca shkencore, etj. (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Të gjitha dëshmitë duhet të përgatiten sipas shtojcës I dhe II e cila gjendet në Rregulloren për Zgjedhjen dhe Rizgjedhjen e punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve të Institutit.

Kandidatët me rastin e aplikimit, dokumentacionit i bashkëngjisin kopjet mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

#### Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të tij në faqen zyrtare të Institutit në internet.

Zgjedhja e personelit shkencor të Institutit Pedagogjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore - shkencore, të Statutit të Institutit Pedagogjik dhe të Rregullores për Procedurat e zgjedhjes, Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/20020169, prej orës 08:00 - 16:00.

#### Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në adresën: Instituti Pedagogjik i Kosovës në Prishtinë, (Pejton, rruga "Lorenç Antoni", nr. 38).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
VLADA KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS  
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA  
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Priština, 14.11.2024

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/02 maj 2013), član 48 Statuta Pedagoškog instituta Kosova u Prištini, Uredbe br. 55/24 od 12.09.2024. o procedurama selekcije i reizbora naučnih radnika i istraživača u Pedagoškom institutu Kosova, član 32, Zakona o radu br. 03/L212, odluka br.67/24, datira 13.11.2024 Naučno veće Instituta objavljuje:

## KONKURS

### za IZBOR, REIZBOR – NAPREDOVANJE NAUČNIH RADNIKA I ISTRAŽIVAČA

2. 2 (Dva) naučna saradnika, od kojih:
  - 2.1. 1 (Jedan) naučni saradnik za udžbenike i nastavna sredstva;
  - 2.2. 1 (Jedan) naučni saradnik za nastavnu oblast Jezici i komunikacije;

#### Opis poslova za radno mesto 1.1.

- Dizajnira istraživačko – naučne projekte iz relevantne oblasti;
- Analizira, vrednuje i istražuje u oblasti udžbenika i nastavnih sredstava;
- Sprovodi istraživanja o podobnosti udžbenika za nivo preduniverzitetskog obrazovanja;
- Organizuje stručne debate o podobnosti udžbenika i nastavnih sredstava;
- Samostalno radi u naučno-istraživačkom radu koje odobrava nadležni organ, prema odobrenom planu;
- Priprema za objavljivanje izveštaje o završenim studijama, materijalima i publikacijama iz delokruga odgovarajućeg odeljenja/odseka;
- Obavlja poslove u okviru zajedničkih istraživačko-naučnih projekata u oblasti udžbenika i nastavnih sredstava;
- Bavi se podizanjem istraživačko-naučnih kapaciteta u Institutu;
- Pomaže naučnim i stručnim zaposlenima u obavljanju poslova;
- Izrađuje plan rada za godišnje, pojedinačne i departamentske/sektorske aktivnosti;
- Piše preglede i ocene na zahtev Institucije;
- Izrađuje izveštaj o izvršenim radovima;
- Obavlja i druge poslove koje mu poveri šef odeljenja i direktor.



**Opis poslova za radno mesto 1.2.**

- Dizajnira istraživačko – naučne projekte iz relevantne oblasti albanskog jezika i komunikacije;
- Izvodi naučne studije iz oblasti albanskog jezika i komunikacionih programa;
- Izvodi naučne studije o metodici nastave albanskog jezika i književnosti;
- Izrađuje naučne studije iz oblasti nastave, učenja i vrednovanja iz predmeta jezik i književnost;
- Analizira stručno usavršavanje nastavnika u kurikularnoj oblasti jezika i komunikacije;
- Izrađuje studije iz oblasti predmetnih nastavnih planova i programa i nastavnih sadržaja albanskog jezika i književnosti u sveobuhvatnom obrazovanju;
- Realizuje naučne studije u vezi sa međunarodnim testovima iz oblasti kulture čitanja;
- Samostalno radi u naučno-istraživačkom radu koje odobrava nadležni organ, prema odobrenom planu;
- Priprema za objavljivanje izveštaje o završenim studijama, materijalima i publikacijama iz delokruga odgovarajućeg odeljenja/odseka;
- Obavlja poslove u okviru zajedničkih istraživačko-naučnih projekata iz oblasti čitalačke kulture;
- Bavi se podizanjem istraživačko-naučnih kapaciteta u Institutu;
- Pomaže naučnim i stručnim zaposlenima u obavljanju poslova;
- Izrađuje plan rada za godišnje, pojedinačne i departamentske/sektorske aktivnosti;
- Piše preglede i ocene na zahtev Institucije;
- Izrađuje izveštaj o izvršenim radovima;
- Obavlja i druge poslove koje mu poveri šef odeljenja i direktor.

**Kandidat za naučnog saradnika mora da ispunjava ove uslove:**

- Da ima stepen doktora nauka;
- Ima najmanje jedan (1) naučni rad objavljen u bilo kom relevantnom međunarodnom časopisu. Radovi moraju biti poznati prema važećim propisima;
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima, unutar i van zemlje, iz relevantne oblasti;
- Da ima dokazano iskustvo u naučnim i stručnim aktivnostima iz oblasti tražene konkursa;
- Da ima objavljene naučne monografije iz relevantne oblasti.

**Potrebna dokumentacija**

Kandidat je dužan da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diploma o završenim relevantnim studijama (doktorat);
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci;
- Dokaz nadležnog suda kojim se dokazuje da kandidat nije osuđivan;
- Ažuriran CV, uz koji se moraju priložiti potrebni dokazi za potvrdu situacije koja je prikazana;
- Spisak publikacija u priznatim međunarodnim časopisima prema važećim propisima, sa isticanjem: autora/e, naslova rada, časopisa, broja i/ili obima publikacije kao i linka za indeksiranje sa DOI brojem (sa kopijom prezentovanih publikacija).
- Spisak publikacija u drugim domaćim i međunarodnim časopisima, sa isticanjem: autora/i, naslova publikacije, vrste publikacije, izdavača i naziva publikacije sa <https://www...> (sa kopijom predstavljenih publikacija).
- Druge dokaze o naučnim i stručnim dostignućima kao što su: članci, knjige, monografije, naučni skupovi i dr. (sa kopijom predstavljenih publikacija).
- Svi dokazi moraju biti pripremljeni prema Prilogu I i II koji se nalazi u Pravilniku o izboru i reizboru naučnih radnika i istraživača Instituta.

Prilikom konkurisanja, kandidati uz dokumentaciju prilažu kopije kvalifikacija, iskustva i drugu potrebnu dokumentaciju koja je potrebna za posao za koji konkuriraju.

**Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na zvaničnoj internet stranici Instituta.**

Izbor naučnog kadra Pedagoškog instituta vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj delatnosti, Statuta Pedagoškog instituta i Pravilnika o postupku izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača.

Kandidati izabrani u uži izbor biće obavesteni pisanim putem ili telefonom u zakonskom roku od strane Instituta, a dužni su da sa sobom ponesu originalna dokumenta o kvalifikacijama i obuci koja je sprovedena radi provere pred Komisijom.

Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj, telefon: 038/20020169, od 08:00 - 16:00 časova.

**Popunjena dokumentacija se dostavlja na adresu: Pedagoški institut Kosova u Prištini, (Pejton, ulica „Lorenč Antoni“ br. 38).**



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS  
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA  
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Prishtinë, 14.11.2024

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimor-shkencor (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024 për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L212, vendimit nr.67/24, të datës 13.11.2024 Këshilli Shkencor i Institutit, shpallë:

### KONKURS ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE - AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE TË HULUMTUESVE

2 (Dy) hulumtues të pavarur, prej të cilëve:

- 1.1. 1 (Një) hulumtues të pavarur për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi;
- 1.2. 1 (Një) hulumtues të pavarur për udhëheqje dhe menaxhim në arsim;

**Përshkrimi i punëve për pozitën 1.1.**

- Bën hulumtime analiza dhe projekte në fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi;
- Analizon programet lëndore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- Propozon dhe përgatit tema dhe projekte të caktuara që lidhen me fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- Bën analiza, vlerësime dhe hulumtime profesionale që lidhen me fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, individualisht dhe në bashkëpunim me punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit;
- Organizon dhe koordinon trajnime profesionale në fushën përkatëse si dhe ndërmjetëson organizimin e trajnimeve;
- Ndihmon punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit, në përgatitjen e botimeve të ndryshme dhe në nxjerrjen e revistës së IPK-së;
- Organizon punëtori në fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, si dhe në zbatimin e kurrikulave në arsim parauniversitar;
- Harton planin individual të punës kërkimore-shkencore dhe profesionale;
- Përgatit raportin për punët e realizuara
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

**Përshkrimi i punëve për pozitën 1.2.**

- Bën hulumtime analiza dhe projekte në fushën e udhëheqjes dhe të menaxhimit në arsim;
- Analizon politikat dhe legjislacionin e fushës së udhëheqjes dhe menaxhimit në arsim;
- Propozon dhe përgatit tema dhe projekte të caktuara që lidhen me udhëheqjes dhe menaxhimit në arsimin parauniversitar;
- Bën analiza, vlerësime dhe hulumtime profesionale që lidhen me fushën e udhëheqjes dhe menaxhimit në arsim, individualisht dhe në bashkëpunim me punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit;
- Organizon dhe koordinon trajnime profesionale në fushën përkatëse si dhe ndërmjetëson organizimin e trajnimeve;
- Ndihmon punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit, në përgatitjen e botimeve të ndryshme dhe në nxjerrjen e revistës së IPK-së;
- Organizon punëtori në fushën udhëheqjes dhe menaxhimit në arsim, si dhe në zbatimin e legjislacionit në arsimin parauniversitar;
- Harton planin individual të punës kërkimore-shkencore dhe profesionale;
- Përgatit raportin për punët e realizuara
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

**Kandidati për hulumtues të pavarur duhet t'i plotësojë këto kushte:**

- Të jetë i/e regjistruar në studimet e doktoratës në programe relevante me pozitën e shpallur dhe fushëveprimtarinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore të indeksuara. Punimet e publikuara në revista shkencore të indeksuara duhet të jenë të njohura sipas rregulloreve në fuqi.
- Të ketë punime të publikuara në revistën "Kërkime Pedagogjike".
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit, nga fusha përkatëse.
- Të ketë marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, nga fusha përkatëse;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitetet shkencore e profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs.



**Dokumentacioni i nevojshëm**

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Dëshmi për regjistrimin e studimeve të (doktoratës);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dëshmi të lëshuar nga Gjykata kompetente, përmes së cilës dëshkohet që kandidati nuk është i dënuar;
- CV-në e përditësuar, së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Listën e botimeve në revista ndërkombëtare të njohura sipas rregulloreve në fuqi duke evidentuar: autori/ët, titulli i punimit, revista, numri dhe/apo vëllimi i botimit si dhe linku i indeksimit me numër DOI (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Listën e botimeve në revista tjera, vendore e ndërkombëtare duke evidentuar: autori/ët, titulli i botimit, lloji i botimit, botuesi dhe vegëza e botimit me <https://www...> (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Dëshmi tjera për të arriturat shkencore si: artikuj, libra, monografi, konferenca shkencore, etj. (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Të gjitha dëshmitë duhet të përgatiten sipas shtojcës I dhe II e cila gjendet në Rregulloren për Zgjedhjen dhe Rizgjedhjen e punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve të Institutit.

Kandidatët me rastin e aplikimit dokumentacionit i bashkëngjisin kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të tij në faqen zyrtare të Institutit në internet.**

Zgjedhja e personelit shkencor të Institutit Pedagogjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore - shkencore, të Statutit të Institutit Pedagogjik dhe të Rregullores për Procedurat e zgjedhjes, Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/20020169, prej orës 08:00 - 16:00.

**Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në adresën: Instituti Pedagogjik i Kosovës në Prishtinë, (Pejton, rruga "Lorenc Antoni", nr. 38).**

**Opis poslova za radno mesto 1.2.**

- Sprovodi istraživanja, analize i projekte iz oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju;
- Analizira politike i zakonodavstvo u oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju;
- Predlaže i priprema određene teme i projekte koji se odnose na liderstvo i menadžment na preduniverzitetskom obrazovanju;
- Izrađuje analize, evaluacije i stručna istraživanja iz oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju, samostalno i u saradnji sa naučnim i stručnim radnicima Instituta;
- Organizuje i koordinira stručna usavršavanja iz odgovarajuće oblasti kao i posreduje u organizaciji obuka;
- Pomaže naučnim i stručnim radnicima Instituta u pripremi raznih publikacija i izdavanju časopisa PIK;
- Organizuje radionice iz oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju, kao i implementacije zakonodavstva u preduniverzitetskom obrazovanju;
- Izrađuje individualni plan istraživačko-naučnog i stručnog rada;
- Izrađuje izveštaj o izvršenim radovima
- Obavlja i druge poslove koje mu poveri šef odeljenja i direktor.

**Kandidat za nezavisnog istraživača mora ispuniti ove uslove:**

- Da je registrovan na doktorskim studijama i na relevantnim programima sa objavljenim položajem i delokrugom Pedagoškog instituta Kosova;
- Da radove objavljuje u indeksiranim naučnim časopisima. Radovi objavljeni u indeksiranim naučnim časopisima moraju biti priznati prema važećim propisima.
- Da radovi budu objavljeni u časopisu „Pedagoška istraživanja”.
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima, unutar i van zemlje, u relevantnoj oblasti.
- Da je aktivno učestvovao na domaćim i međunarodnim konferencijama iz relevantne oblasti;
- Da ima dokazano iskustvo u naučnim i stručnim aktivnostima iz oblasti tražene konkursom.

**Opis poslova za radno mesto 1.2.**

- Sprovodi istraživanja, analize i projekte iz oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju;
- Analizira politike i zakonodavstvo u oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju;
- Predlaže i priprema određene teme i projekte koji se odnose na liderstvo i menadžment na preduniverzitetskom obrazovanju;
- Izrađuje analize, evaluacije i stručna istraživanja iz oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju, samostalno i u saradnji sa naučnim i stručnim radnicima Instituta;
- Organizuje i koordinira stručna usavršavanja iz odgovarajuće oblasti kao i posreduje u organizaciji obuka;
- Pomaže naučnim i stručnim radnicima Instituta u pripremi raznih publikacija i izdavanju časopisa PIK;
- Organizuje radionice iz oblasti liderstva i menadžmenta u obrazovanju, kao i implementacije zakonodavstva u preduniverzitetskom obrazovanju;
- Izrađuje individualni plan istraživačko-naučnog i stručnog rada;
- Izrađuje izveštaj o izvršenim radovima
- Obavlja i druge poslove koje mu poveri šef odeljenja i direktor.

**Kandidat za nezavisnog istraživača mora ispuniti ove uslove:**

- Da je registrovan na doktorskim studijama i na relevantnim programima sa objavljenim položajem i delokrugom Pedagoškog instituta Kosova;
- Da radove objavljuje u indeksiranim naučnim časopisima. Radovi objavljeni u indeksiranim naučnim časopisima moraju biti priznati prema važećim propisima.
- Da radovi budu objavljeni u časopisu „Pedagoška istraživanja”.
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima, unutar i van zemlje, u relevantnoj oblasti.
- Da je aktivno učestvovao na domaćim i međunarodnim konferencijama iz relevantne oblasti;
- Da ima dokazano iskustvo u naučnim i stručnim aktivnostima iz oblasti tražene konkursom.

**Potrebna dokumentacija**

Kandidat je dužan da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Dokaz o upisu (doktorskih) studija;
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci;
- Dokaz nadležnog suda kojim se dokazuje da kandidat nije osuđivan;
- Ažuriran CV, uz koji se moraju priložiti potrebni dokazi za potvrđivanje situacije koja je prikazana;
- Spisak publikacija u priznatim međunarodnim časopisima prema važećim propisima, sa isticanjem: autora/e, naslova rada, časopisa, broja i/ili obima publikacije kao i linka za indeksiranje sa DOI brojem (sa kopijom prezentovanih publikacija).
- Spisak publikacija u drugim domaćim i međunarodnim časopisima, sa isticanjem: autora/i, naslova publikacije, vrste publikacije, izdavača i naziva publikacije sa <https://www...> (sa kopijom objavljenih publikacija).
- Drugi dokazi o naučnim dostignućima kao što su: članci, knjige, monografije, naučne konferencije itd. (sa kopijom objavljenih publikacija).
- Svi dokazi moraju biti pripremljeni prema Prilogu I i II koji se nalazi u Pravilniku o izboru i reizboru naučnih radnika i istraživača Instituta.

Prilikom prijave kandidati uz dokumentaciju prilažu kopije dokumenata o stručnoj spremi, iskustvu i drugu potrebnu dokumentaciju koja je potrebna za posao za koji konkuriraju.

**Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na zvaničnoj internet stranici Instituta.**

Izbor naučnog osoblja Pedagoškog instituta vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj delatnosti, Statuta Pedagoškog instituta i Pravilnika o postupku izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača.

Kandidati izabrani u uži izbor biće obavesteni pisanim putem ili telefonom u zakonskom roku od strane Instituta, a dužni su da sa sobom ponesu originalna dokumenta o kvalifikacijama i obuci koja je sprovedena radi provere pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovaj broj. telefon: 038/20020169, od 08:00 - 16:00 časova.

**Popunjena dokumentacija se dostavlja na adresu: Pedagoški institut Kosova u Prištini, (Pejton, ulica „Lorenc Antoni“ br. 38).**



 <p>KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A. REGIONAL WATER COMPANY J.S.C. REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOOSNABDEVANJE D.D. <b>PRISHTINA</b></p>	 <p>german cooperation DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT</p>	
<p>NOTIFICATION OF AVAILABILITY OF THE SCOPING REPORT FOR THE PROJECT CLIMATE APPROPRIATE URBAN DEVELOPMENT: SEWAGE PRISHTINA (INCL. SEWAGE I/II)</p> <p>As part of an agreement between the Republic of Kosovo and the Federal Republic of Germany, this project will contribute to environmentally friendly, hygienically safe, and sustainable wastewater and stormwater management in Greater Prishtina. This project is also in line with the national wastewater and resource protection strategy while fostering alignment with EU Standards, thereby contributing to sustainable urban development and climate adaptation.</p> <p>The Scoping Report, being prepared as part of this project, identifies possible environmental and social impacts and sets the stage for the further course of the project, ensuring that both national and international standards are met.</p> <p>This Report is now available on the website of the Regional Water Company Prishtina: <a href="http://www.kru-prishtina.com">www.kru-prishtina.com</a></p> <p>The public is invited to provide comments and suggestions on this Report within 30 days from the date of disclosure of this announcement on the address given in this Report</p>	<p>NJOFTIM PËR DISPONUESHMËRINË E RAPORTIT TË FUSHEVEPRIMIT PËR PROJEKTIN ZHVILLIM URBAN I PËRSHTATSHËM NDAJ KLIMËS: KANALIZIMI PRISHTINA (PËRFSHIRË KANALIZIMIN I/II)</p> <p>Në kuadër të Marrëveshjes mes Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ky projekt do të kontribuojë në menaxhim të qëndrueshëm të ujërave të ndotura dhe ujërave të shiut, në formë miqësore ndaj mjedisit dhe higjienikisht të sigurt në Prishtinë dhe rrethinë. Ky projekt është gjithashtu në përputhje me strategjinë kombëtare për mbrojtjen e burimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, duke përkrahur njëkohësisht përputhjen me standardet e BE-së dhe duke kontribuar në zhvillimin urban të qëndrueshëm dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Raporti i Fushëveprimit i cili përgatitet si pjesë e këtij projekti, identifikon ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale dhe vendos bazën për ecurinë e mëtejshme të projektit, duke siguruar që të përbushen standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Ky Raport tani është i disponueshëm në faqen e internetit të Kompanisë Rajonale të Ujit Prishtina: <a href="http://www.kru-prishtina.com">www.kru-prishtina.com</a></p> <p>Publiku ftohet të japë komente dhe sugjerime për këtë Raport brenda 30 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën e dhënë në këtë Raport.</p>	<p>OBAVEŠTENJE O DOSTUPNOSTI IZVEŠTAJA O DELU ZA KLIMATSKI POGODAN URBANISTIČKI RAZVOJNI PROJEKAT: KANALIZACIJA PRIŠTINE (UKLUČUJUĆI KANALIZACIJU I/II)</p> <p>U okviru sporazuma između Republike Kosovo i Savezne Republike Nemačke, ovaj projekat će doprineti održivom upravljanju zagađenom vodom i kišnicom, na ekološki i higijenski bezbedan način u Prištini i njenoj okolini. Ovaj projekat je takođe u skladu sa nacionalnom strategijom za zaštitu resursa i tretman otpadnih voda, podržavajući usklađenost sa standardima EU i doprinoseći održivom urbanom razvoju i prilagođavanju klimatskim promenama.</p> <p>Izveštaj o obimu, koji je pripremljen kao deo ovog projekta, identifikuje potencijalne ekološke i društvene uticaje i uspostavlja osnovu za dalji napredak projekta, obezbeđujući da su nacionalni i međunarodni standardi ispunjeni.</p> <p>Ovaj izveštaj je sada dostupan na veb-stranici Regionalnog vodovoda Prištine: <a href="http://vuv.kru-prishtina.com">vuv.kru-prishtina.com</a></p> <p>Poziva se javnost da da komentare i sugestije na ovaj Izveštaj u roku od 30 dana od dana objavljivanja ovog obaveštenja na adresi navedenoj u ovom Izveštaju.</p>



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

---

# SWISS

## TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Saranda Gjonaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

